

V E N D I M
"PËR HEQJEN E SEKUESTROS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e perbërë nga:

GJYQTARI ALTIN SHKURTI

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Natasha Azemaj** dhe me pjesëmarrjen e pokurores Suela Salavaci, në Tiranë sot me datë 11/02/2016, mori në shqyrtim materialin procedures që i përket:

KËRKUES: R. O., i biri i V. dhe i D. idtl. 22.06.19.., lindur në Durës dhe banues në Tiranë, përfaqësura nga Av. Mirash Martini me prokurë të posacme Nr. 177 Rep. 43 Kol., datë 11.02.2016

OBJEKTI: Heqje e sekuestros dhe kthimin e paarve të sekuestruara në llogarinë e kërkuesit në Bankën Credins

BAZA LIGJORE: Neni 210, 217 dhe 218 të K.Pr.Penale

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e kërkesuit për heqjen e sekuestros të vendosur mbi llogaritë bankare të shtetasve R. O. dhe M. N. në Bankën Credins Sh.A. dhe kthimin e paarve dhe dëgjoi në përfundim kërkuesin që kërkoi pranimin e kërkesës, prokuroren që kërkoi pranimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi

V Ë R E N:

Se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar procedimin penal Nr. 9912 të vitit 2015.

Gjatë seancë gjyqësore rezultoi se:

Drejtorja e Pergjithshme e Parandalimit te pastrimit parave, me ane te shkreses me Nr. ..., date 18.12.2015, ka leshuar urdherin Nr. ..., per Bankes CREDINS SH.A., per bllokim te perkohshem te transaksioneve të shtetasit R. V. O., pasi me date 14.12.2015 ne Ilogarine e tij prane Credins Banke ka mberitur nje transferte ne vleren 135 645 Euro. Kjo transferte eshte derguar nga Litchentein po nga llogaria e tij me shenimin "mbyllje llogarie".

Nga informacioni ne burime te hapura ne emer te shtetasit te mesiperm rezulton se shtetasi R. O. eshte i perfshire ne afere korrupsioni per te ashtuquajturin "tender" i aparaturave mjekesora per Spitalin Universitar te semundjeve te mushkeriva "Shefqet Ndroqi". Sipas te dhenave rezulton se ne vitin 2009 shtetasi R. O. ishte drejtor i spitalit "Shefqet N droqi". Ai dhe bashkeshortja e tij shtetasja M. N. jane pjese e organikes se Fakultetit te Mjekesise perkatësisht pjese e seksionit te sherbimit te Kirurgjise se Pergjithshme dhe Fizologjise.

Ne lidhje me shtetasin R. O. dhe bashkeshorton e tij shtetasen M. K. N., rezulton se ka transaksione te vlerave ne menyre te permbledhur si vijon:

- R. O.
-
- Me date 20.04.2010 sipas kontrates nr.rep/kol/.../... i ka shitur shtetase V. Z. K. pasuri te palujtshme ne vlere 6370 000 Leke;
- Me date 04.01.2011 ka blere nga "Asa AUTO STAR Albania" shpk nepermjet Tirana Leasing automjet ne vlere 7 909 320 Leke.
- Me date 25.03.2014 i ka shitur shtetasit I. H. K. automjet (BMË X 6) ne vleren 50 000 Euro;
- Me date 03.06.2014 i ka shitur shtetasit A. Q. C. automjet (BMË vleren 30000 Euro;
- Me date 19.11.2014 ka marre hua nga shtetasi K. T. N. shumen 100 000 Euro;
- Me date 10.04.2015 ka kryer nje pagese te pjesshme cash ne favor te shoqerise "D... ..." me NIPT J8...3U sipas kontrates nr.1901 rep, nr.441 kol.
- Ne intervali kohor 2010-2015 ka kryer transaksione (si terheqje, pagesa per leasing, depozitime etj) ne banka te ndryshme ne shuma qe arrijne deri ne 100 000 Euro, keshtu mund te evidentojme:
- Me date 30.03.2012 prane Credins banke ne llogari te tij eshte kryer kembim valutor ne shumen 8 424 000 Leke;
- Me date 10.12.2012 ka terhequr nga llogaria prane BKT shumen 25000 Euro;
- Me date 10.04.2014 ka terhequr nga llogaria prane BKT shumen 100 000 Euro me qellim blerje pasurie te paluajtshme;
- Me date 29.09.2014 ka derdhur ne llogari prane RZB shumen 38 5000 Euro me burim te ardhurash shitje makine;

M. N.

Me date 07.10.2014 ka blere automjet (BMË) nga shtetasi I. P. J. ne vleren 30000 Euro;

Me date 17.03.2015 i ka shitur shtetasit Th. J. K. automjet (BMË) ne vleren 28 000 Euro;

Nga verifikimi ne QKR ne emer te shtetasve te mesiper rezulton se shtetasi R. O. eshte aksioner (51 % te kuotave) ne aktivitetin tregtar "A..." shpk me NIPT L2...2D. Ky aktivitet eshte themeluar me date 19.09.2012 ne Tirane e me objekt te veprimtarise "Import-Eksport te produkteve disinfektuese". Aksioner gjithashtu eshte edhe shtetasi A. T., i datelindjes 15.12.19.. (49);

Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te pastrimit parave, me ane te shkreses me Nr. .../..., date 18.12.2015, ka leshuar urdherin me Nr. ..., per banken "CREDINS", per bllokim te perkohshem te transaksioneve te shtetasve.

Në bazë të kërkesës së organit të akuzës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr. 1570, datë 21/12/2015 ka vendosur sekuestrimin e parave të ndodhura në të gjithë llogaritë bankare të shtetasve R. O. dhe M. N. në Bankën Credins Sh.A.

Organi i akuzës ka kryer hetimet e nevojshme mbi këtë çështje nga ku ka rezultuar se shtetasit R. O. ka nënshkruar në datën 15.08.2009 akt marrëveshjen me shoqërsinë M... ltd, duke e emëruar atë këshilltar për një afat 18muor me një pagë ditore 1800 Euro/ditë në maksimum deri në 180 000 Euro gjithësej.

Po kështu kërkuesi R. O. edhe bashkëshortja e tij M. N. kanë nënshkruar kontratë me A... I... sh.p.k. me seli në Vjenë Austri.

Kërkuesi R. O. me datë 01.04.2012 ka nënshkruar kontratë me A... me afat 2 vjecar për të kryer shërbime konsulenti të këaj kompanie në Shqipëri dhe Kosovë me një pagë prej 1500 Euro/ditë pune që mbulon edhe tarifën e infrastrukturës dhe zyrës së tij. Kjo kontratë është rilidhur përsëri me datë 12 janar 2015 me të njëjtat kushte si ajo e mësiparmja.

Po kështu edhe shtetësja M. N. ka lidhur me A... I... Sh.P.K. më 10 shkurt 2014 një kontratë për të kryer shërbime këshilluesi të kesaj shoqërie për një afat njëvjecar me tarifë shërbimi gjithësej 150 000 Eur, ku 75 000 Euro për menaxhimin e projektit dhe shërbimeve këshillimore dhe 75 000 Euro për shërbime këshilluese dhe inxhinjerike.

Gjatë shyrimit gjyqësor rezultoi se veprimet bankare janë kryer në bazë të dokumentve fianciare. Në bazë të faturave të lshuara nga kërkuesi per A... I... GmbH ne Vjene Austri dhe konkretisht: fatura 01-15-07 e dates 1 korrik 2015 per shumen 24 000 Euro, faturen 28-15-04 e dates 28 prill 2015 per shumen 10 500 Euro, fatura 01-05-07 e dates 01 prill 2015 ne vleren 45 000 euro, transferta bankare nga Landesbank e dates 01.02.2010 qe eshte paguar nga M... shumen prej 178 500 Euro, Transferte bankare nga Landesbank e dates

11.12.2015 qe ka derguar me daten 11.12.2015 shumen prej 135 756.60 Euro, nxjerrje e te dhenave nga llogaria qe une kerkuesi R. O. kam ne UNIONBANK per periudhen 01.07.2015 deri me daten 19 janar 2016.

Bazuar në këto prova të paraqitura nga kërkuesi organi i akuzës ka arritu në konkluzioni se burimet e parave të sekusetruar në Bankën Credins Sh.A. në emër të kërkesuit R. O. dhe bashkëshortes së tij M. N. janë të verifikuar si të ligjshm. Pë rrjedhojë organi i akuzës shprehet dakort për heqjen e sekuestros dhe kthimin e shumave të të hollave të sekuestruar shtetasve R. O. dhe M. N..

Nga sa argumentuam më sipër gjykata cmon që në rastin në gjykim vërtetohet ligjshmria e shumave të të hollave të depozituar në llogaritë bankare në emër të shtetasve R. O. dhe M. N., në Bankën Credins Sh.A.. Për rrjedhojë gjykata cmon që në rastin në gjykim duhet të hiqet seksuestroja e vendosur me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 1570 Akti, datë 21/12/2015 duke u kthyer këtyre shtetasve shumën e të hollave të sekuestruara.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata duke u bazuar në nenet 210 të K.Pr.Penale

VENDOSI

- Heqjen e sekuestros së vendosur me vendimin Nr. 1570 Akti., mbi llogaritë bankare të shtetasit R. O. dhe M. N. në Bankën Credins Sh.a. dhe kthimin e parave të sekuestruara shtetasve R. O. dhe M. N..

-Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, sipas ligjit.

-U shpall në Tiranë sot me datë 11.02.2016

SEKRETARE

GJYQTARI

NATASHA AZEMAJ

ALTIN SHKURTI